

Recension

POEZI ME MESAZH EMOCIONAL PËR DASHURINË DHE JETËN

Besim Xhelili: "Besa", poezi. Botoi Shtëpia Botuese "Fishta" Prishtinë, 2016

Demir Reshiti

Poeti që tashmë ka bërë emër në letrat shqipe, Besim Xhelili, autor i vëllimeve poetike "Emocione" (1996), "Unë në sytë e tu" (2007), "Baladë e ngrirë", (2012) dhe "Mes luleve dhe lotit", (2013), vjen para lexuesve me vëllimin më të ri poetik që mban titullin simbolik "Besa".

Tetëdhjetenjë poezitë në këtë vëllim nuk janë të ndara në kapituj por ato radhiten njëra pas tjetrës si një vazhdimësi, si një triko që thuret rrjedhshëm dhe i ngjanë vargut të ditëve të endura gjatë gjithë jetës.

Ta lexosh poezinë e dikujt nënkupton ta zbulosh botën e tij të fshehur, ta përcjellësh rrugën e ndërdijes së tij, të jetosh me vargjet e tij, të mendosh me mendimet e tij, t'i ndjesh emocionet e tij.

Pavarësisht nëse shkruan me rimë apo varg të lirë, vargu i Besim Xhelilit gjithmonë është i përcaktuar si një tërësi harmonike e ritmike. Me vargjet e tij është lehtë të identifikohesh.

Të ecish në shtigjet e poezisë së Besimit është një aventurë interesante dhe e bukur në të cilën nuk të presin stuhi dhe përmytje, por ëndrra jete të thurura me përkushtim me të cilat ai komunikon me lexuesit, duke ia zbuluar emocionet e tij, përvojën jetësore dhe urtësitë e jetës. Mesazhi emocional i poezisë së tij është i hapur për jetën dhe gjithçka që sjell ajo. Tematika dominuese e poezisë së tij është dashuria; dashuria ndaj njeriut, dashuria ndaj peizazhit, dashuria ndaj jetës dhe të gjitha dukurive të saj.

Vetes ia dëshiroj një sëmundje të pashërueshme

A mundet pa ty dita të jetë e gëzueshme?

Jeta jonë një labirint i pasqaruar

Por, zemrat nga larg aq fort dashuruar... / RRUGËT E JETËS/

Poeti nuk i nënshtrohet lumit vërshues të jetës, por e jeton atë aktivisht, duke ndikuar në ngjarjet, duke e korrigjuar rrjedhën e tij madje edhe në ëndrra. Dhe në atë korrigjim ai është gjithmonë në kërkim të anës së ndritshme të jetës, bukurisë së saj, romancës, lumturisë...

*Lumturia ka kuptim nëse dhemb
Nga ky tru nuk del gjë e vlefshme,
Fundi i detit nuk e merr të kaluarën
Por, thellësia e syve të tu... / ËNDRRA TË EGRA/*

Duke e jetuar përditshmërinë e jetës, autori fut brenda saj gëzim, ngrohtësi, fat dhe energji të pabesueshme jetësore. Autori është i vetëdijshëm se jeta nuk është vetëm këngë e pa ndërprerë, por ajo ka edhe ngjyra të zeza. Ai këto momente përpiqet që t'i kapërcejë sa më shpejt që është e mundur, t'i largojë nga përditshmëria e tij.

*E shkurtë jeta të gjehet lumturia
Nuk thahet loti kur zemra copëtohet,
I besoj dhimbjes sate, s'më kap xhelozia
Se gëzimi yt e bën fytyrën time të gëzohet... / PIKËLLIMI YT/*

Impresionon optimizmi i tij jetësor, aftësia për t'u përshtatur, aftësia për të krijuar gëzim e cila gjendet në të gjitha aspektet e jetës.

*Sa ashpër robërojnë ato ngjyra dashurie absurde...
Kur gjeta veten pas luftërave me kotësinë
Si një dritë e fortë mes rrezeve ti u shfaqe,
Që atëherë fillova ta ndiej dashurinë
E nuk prisja dot t'i shoh n'mëngjes ato faqe... / KOTËSIA DHE HIÇI/*

Poezia e Besim Xhelilit shpesh është narrative. Me gjallëri dhe varg ekspresiv krijon rrëfimin dhe e pikturon atë me ngjyrat përrallore romantike. Vizualiteti në poezinë e tij është fort i theksuar. Imazhet e tij janë të thjeshta, të pastra, ngjyrat janë të theksuara dhe para syve të lexuesve rrjedhin si një peizazh i pikturuar gjatë gjithë jetës. Këto ngjyra dhe këta tinguj janë të shkruara në aromën e dashurisë e cila ndjehet me të gjitha shqisat.

*Mbi ballin e përkryer të ka rënë një filiz i flokut
Dy buzët e ngjyrosura me shije më kanë bërë rob,
I brishtë ky vrull helmues i ndjenjave...
Dalim jashtë për ajër se ngulfatemi shpesh
Orë e çast afshi na tret zemrat,
Rrokullisen ditët pa na marrë me vete
Është aq e nxehtë kjo kohë, frikësohemi
Ndaj, presim të nesërmen çka na sjell... / SYTË AFSHPLOTË RRUFESHËM
ATERUAN NË DASHURINË ABSTRAKTE/*

Njeriu dhe dëshira e tij për jetën e dashurinë është e tërë përmbajtja e tij e brendshme, grimcë e botës së përgjithshme dhe jetë e botës së dukshme, të gjitha dukuritë janë vetëm një pasqyrë e dëshirës fundamentale të njeriut për dashuri. Andaj jeta është shoqëruese e pandarë e dëshirës, siç është për shembull hija shoqëruese e trupit që u është ekspozuar rrezeve të diellit, dhe gjithkund ku është vullneti njeriut, aty është edhe jeta dhe bota.

Duke jetuar çdo ditë me poezinë e tij, autori ka ndërtuar botën e tij poetike të veçantë, origjinale, të njohur, vetëm të tij. Tabloja themelore e asaj bote është gjithnjë e njëjtë; ai dhe ajo janë në momentet më intime të jetës, momentet e dashurisë, momentet e dorëzimit të plotë që i shfaqen edhe në ëndrra.

*Sa herë shoh fytyrën e saj të buzëqeshur
I kujtoj ditët kur e kisha afër dhe e ndjeja,
Tërë trupin kur me emocione kisha veshur
Ëndrrat e gëzueshme me të kur i gjeja... /ËNDËRR E LUMTUR/*

Të shkruash për dashuri nuk është lehtë. Nuk është lehtë të variohet gjithnjë në të njëjtën temë sepse rrezikohet që sintagmat të përsëriten, që pamjet të bëhen të njohura, që shihen si pjesë e koloritit.

Mashkulli në këto poezi dominon. Ai është plot epsh. Afrohet dhe largohet i lirë në ecejaket e tij. Femra në këto vargje krijohet në mijëra mënyra. Ajo është e lirë, intuitive, e nënshtruar ndaj instinkteve, e qasshme, e butë, e arritshme,... por gjithmonë është ajo që në vete bart pasionin e jetës, pasionin e ekzistencës, duke e pulsuar dëshirën e vullnetit të paqëndrueshëm.

Shumë vargje flasin për kujtimet e përjetimeve dhe ngjajnë në testament poetik, si një copëzim i botës intime të poetit. Ngelin kujtimet. Ato autori dëshiron që t'i jetësojë pandërprerë që nga fillimi; kujtimet në një dashuri dalluese, kujtimet në kohën kur ka ekzistuar besimi në dashuri.

Imazhet me të cilat ai futet në imagjinatën e lexuesve janë të pastra, pa paragjykime, ofrohen drejtpërdrejtë të pa megjulluara. Por në momentin e zhveshjes së poezisë, ato bëhen poetike, bymehen, por kurrë nuk plasarin fjalët poetike.

*Besoj...unë zura ëndrrën që ecte si hyjneshë
Më erdhi zemërngrohtësi e mbiqiellit,
Robërova ëmbël ndjenjat... /AFSH ËNDRRASH/*

Besim Xhelili është poet i cili frymon çdo ditë me poezinë e tij, atë e frymëzon dëshira e thellë e cila bartet në nivelin fizik, e cila depërton në poret e lëkurës, ndërsa timonier i saj është dëshira ndaj fjalës së shkruar. Edhe pse në poezinë e tij dominojnë momentet vizuele, kjo poezi nuk është e privuar nga kumbimi i vargut, të cilën autori e kryesisht e arrin me inversions të pazakonshme, ndërsa pasurinë e shprehjeve e thekson me sintetizimin e aromës dhe shijes.

Ndoshta nga gripi tash je shëruar

Unë nga shpirti këtë ta kam uruar,

Kam pritur një mesazh, por asgjë

*Mes kotësisë dhe hiçit s' bëj zë. / SOT AS RETË, AS NATYRA DHUROJNË
AROMË/*

Kjo nevojë e krijimit të poezisë është aq e fuqishme sa ndonjëherë zhduket dallimi në mes të poezisë dhe pasionit fizik dhe ky pasion për të shkruar dhe dëshira fizike njëjtësohen dhe është vështirë të dallohet çfarë i përket dëshirës mashkullore e çfarë dëshirës së poetit.

Jam i mendimit se lexuesi që e lexon këtë përmbledhje poetike do të pasurohet me një përjetim të këndshëm që fsheh brenda bukurinë e poezisë.

Prishtinë, janar 2016